



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR
DREJTORIA E KURRIKILËS DHE KUALIFIKIMIT**

NJOFTIM

Në lidhje me zbatimin e udhëzimeve të reja të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, për zhvillimin e vazhdueshëm profesional të punonjësve arsimorë, konkretisht të udhëzimit nr.16 datë 22.07.2024 “Për organizimin dhe funksionimin e sistemit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional të punonjësve arsimorë”, **Ju informojmë:**

- **Akreditimi:** Bazuar në udhëzimin nr. 16 datë 22.07.2024 “Për organizimin dhe funksionimin e sistemit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional të punonjësve arsimorë”, të gjitha aktivitetet zhvillimin e vazhdueshëm profesional të punonjësve arsimor do të akreditohen dhe do të njihen nga ASCAP.
- **Modulet e akredituara më parë:** Të gjitha agjencitë që kanë akredituar module trajnimi që nga viti 2022, do të vijojnë të ofrojnë trajnime deri në përfundim të vlefshmërisë së tyre sipas vendimit të KAPT-it.
- **Konvertimi i krediteve:** Kreditet e fituara sipas sistemit të vjetër do të konvertohen me sistemin e ri të zhvillimit të vazhdueshëm profesional. Konkretisht, aktivitetet e vlerësuara më parë me 1 kredit tani do të jenë ekuivalente me 10 kredite. Të gjitha kreditet e fituara para vitit shkollor 2023-2024, do të njihen dhe konvertohen më këtë sistem.
- **Certifikatat me kredite:** Certifikatat që do përfitojnë mësuesit nga trajnimet, nga shtatori 2024 e në vijim, deri në përfundim të vlefshmërisë së modulit të akredituar, duhet të konvertohen sipas udhëzimit të ri të ZHVP-së, 1 kredit me 10 kredite.

Faleminderit për bashkëpunimin dhe mirëkuptimin e vazhdueshëm.